

MASTER

NË ADMINISTRIM BIZNESI

Me profil në
E DREJTË BIZNESI

**NDËRTO EKSPERTIZËN LIGJORE
PËR TË UDHËHEQUR
NË BOTËN E BIZNESIT!**

Kohëzgjatja: **24 muaj**
Gjuha: **Shqip**
Fakulteti i Biznesit dhe Drejtësisë

Skano
për më
shumë
info





“Të dashur studentë,
Kurrikula jonë e ndërtuar me kujdes mbulon fushat kyçe të së drejtës dhe biznesit, duke përfshirë gjithashtu zhvillimin e aftësive të buta si mendimi kritik, inovacioni dhe zgjidhja e problemeve.

Këto janë thelbësore për t'iu pajisur me kompetencat e nevojshme për sukses në një treg gjithnjë e më konkurrues dhe global. Ne synojmë të formojmë liderët e së ardhmes në fushën e biznesit, duke ju ofruar jo vetëm mësimdhënie nga profesorë dhe ekspertët më të njohur, por edhe një fokus të veçantë në përvojën praktike.

Përmes partneriteteve strategjike me firmat më me emër në treg, përfshirë Grupin BALFIN, si dhe institucionet publike, organizatat e biznesit dhe zyrat ligjore, studentët tanë do të kenë mundësinë të aplikojnë njohuritë e fituara në situata reale, duke u përgatitur në mënyrë efektive për sfidat e tregut të punës.

Jemi të bindur që ky udhëtim akademik do t'iu pajisë me mjetet e duhura dhe t'iu bëjë më të aftë për të përballuar sfidat komplekse të botës moderne të biznesit.”

Dr. Lorenc Gordani

Drejtuesi Akademik i Masterit në të Drejtë Biznesi


PËRMBLEDHJE E PROGRAMIT

Programi i Masterit në të Drejtë Biznesi ofron një përvojë formuese unike, duke kombinuar njohuritë ligjore me ato të menaxhimit dhe biznesit. Programi fokusohet në ofrimin e një kuptimi të thelluar të sfidave ligjore që përballen korporatat dhe sipërmarrjet në nivele kombëtare dhe ndërkombëtare. Ai përgatit liderë të suksesshëm në fushën e së drejtës së biznesit, duke i pajisur studentët me njohuri dhe kompetenca për t'u angazhuar me profesionalizëm në një ambient gjithnjë e më konkurrues, ndërsa përshtatet me dinamikën e tregut dhe kërkesat e vazhdueshme të industrisë.

INSTITUCIONE PARTNERE



PËRFITIMET



PERSPEKTIVAT E PUNËSIMI TË HAPURA NGA MASTERI NË TË DREJTË BIZNESI:

- Sipërmarrës;
- Drejtues i Zhvillimit të Biznesit;
- Konsulent Ligjor;
- Përfaqësues Ligjor;
- Këshilltar i Korporatave;
- Konsulent ndërkombëtar;
- Avokat;
- Këshilltar i Politikave;
- Drejtor i Çështjeve Ligjore.

PËRMBLEDHJE E PROGRAMIT

Programi i Masterit në të Drejtë Biznesi ofron një kurrikulë të gjerë prej 120 kreditesh ECTS që mbulon disa fusha kyçe për funksionimin dhe menaxhimin efikas dhe përputhshmërinë ligjore të bizneseve. Ai përfshin 8 lëndë në vitin e parë dhe 7 lëndë në vitin e dytë, ndërsa kreditet e tjera fitohen përmes praktikës profesionale dhe provimit të diplomimit.

Më poshtë, po ju paraqesim një përshkrim të grupeve të lëndëve të organizuara sipas fushave kryesore që programi mbulon:

1 | LIDERSHIP, QEVERISJE E KORPORATAVE DHE MARRËDHËNIA E PUNËS

Ky modul lëndësh pajis me njohuri dhe aftësi të rëndësishme për menaxhimin dhe drejtimin e një organizate. Qeverisja e Korporatave i mëson studentët si të zbatojnë korniza menaxhuese, ndërsa Sjellja Organizative dhe Lidërshipi i ndihmojnë të përmirësojnë aftësitë për menaxhimin e dinamikave të brendshme. Zhvillimi Personal dhe Komunikimi Ndërpersonal forcojnë aftësitë për ndërtimin e marrëdhënieve profesionale, ndërkohë që e Drejta e Punës i pajis me njohuri mbi bazat ligjore të marrëdhënieve të punës. Praktika Profesionale lidh teorinë me përvojën reale, duke përgatitur studentët për sfidat praktike.

2 | MENAXHIM DHE VENDIMMARRJE STRATEGJIKE

Ky modul lëndësh ndihmon në zhvillimin e aftësive menaxheriale thelbësore përmes një qasjeje të integruar që përfshin menaxhimin strategjik, menaxhimin e projekteve, vlerësimin dhe sistemet e informacionit. Ai përqendrohet në vendimmarrjen efektive dhe zhvillimin e aftësive të avancuara në këto fusha, duke i përgatitur studentët për të analizuar mjedisin, planifikuar dhe kontrolluar projekte, vlerësuar suksesin e tyre dhe përmirësuar efikasitetin përmes teknologjisë. Moduli përfundon me një integrim praktik të njohurive të fituara, duke i ndihmuar studentët të zgjidhin probleme reale dhe komplekse në fushën e menaxhimit.

3 | FINANCAT, TAKSAT DHE KUADRI NORMATIV I BIZNESIT

Ky modul ofron një kuptim të thellë të legjislacionit financiar dhe menaxhimit të burimeve financiare, të cilat janë thelbësore për vendimmarrjen strategjike të biznesit. Ai mbulon Drejtimin Financiar të Avancuar, Taksimin e Biznesit, si dhe rregulloret që lidhen me të Drejtën Bankare dhe Financiare. Përmes këtyre fushave, studentët aftësohen të analizojnë dhe menaxhojnë risqet financiare, duke garantuar përputhshmëri me ligjet dhe përmirësuar performancën financiare të organizatave.

4 | KUADRI LIGJOR DHE STRATEGJIK PËR ZHVILLIMIN E BIZNESIT

I fundit por me i rëndësishmi, ky modul ofron një kuptim të thelluar të kuadrit ligjor dhe rregullator që mbështet aktivitetet e biznesit. Ai trajton Mjedisin Rregullator të Biznesit, të Drejtën e Biznesit të Avancuar, dhe të Drejtën Civile dhe Kontratat, duke i pajisur studentët me aftësi për të menaxhuar risqet dhe për të siguruar që bizneset operojnë brenda përcaktimeve ligjore. Këto njohuri janë thelbësore për të mbështetur zhvillimin e qëndrueshëm dhe të suksesshëm të organizatave në përputhje me ligjin.

AFTËSITË E ZHVILLIMIT PERSONAL DHE NDËRPERSONAL

- 1. Mendimi Kritik:** Aftësia për të vlerësuar situata dhe informacione nga këndvështrime të ndryshme për të marrë vendime të informuara.
- 2. Zgjidhja e Problemeve:** Aftësia për të analizuar dhe zgjidhur probleme komplekse që ndodhin në ndërveprimin mes sektorëve të ndryshëm, duke gjetur zgjidhje inovative.
- 3. Adaptueshmëria:** Aftësia për t'u përshtatur me ndryshimet dhe për të menaxhuar sfidat që lindin nga bashkëpunimi ndërmjet sektorëve të ndryshëm.
- 4. Menaxhimi i Kohës dhe Prioriteteve:** Aftësia për të organizuar detyrat dhe prioritetet për të përmbushur afatet dhe qëllimet në një mjedis shumësektorial.
- 5. Menaxhimi i Projekteve:** Aftësia për të planifikuar, organizuar dhe menaxhuar projekte që përfshijnë bashkëpunimin ndërmjet sektorëve të ndryshëm.
- 6. Lideriship:** Aftësia për të udhëhequr dhe motivuar ekipe të ndryshme për të arritur objektiva të përbashkët dhe për të krijuar një atmosferë bashkëpunuese.

METODA E MËSIMDHËNIES

Metoda e mësimdhënies në masterin në Të Drejtën e Biznesit përfshin një kombinim të teknikave dhe qasjeve që ndihmojnë në zhvillimin e njohurive dhe aftësive të studentëve. Disa nga metodat kryesore përfshijnë:

1

LEKSIONET DHE DISKUTIMET:

Prezantimi i teorisë dhe koncepteve kryesore përmes ligjëratave dhe diskutimeve mbi kuadrin ligjor dhe rregullator, duke theksuar aspekte praktike.

2

SEMINARET DHE HULUMTIMI:

Seminaret dhe pjesëmarrja në projekte kërkimore që përfshijnë diskutime mbi tema specifike, shpesh të drejtuara nga profesionistë të fushës i ndihmon studentët të zhvillojnë aftësi analitike dhe kritike.

3

STUDIMI I RASTEVE DHE SIMULIMET:

Analizimi i rasteve reale dhe simulimet e situatave të biznesit ndihmojnë studentët të aplikojnë njohuritë dhe të zhvillojnë aftësi si mendimi kritik dhe zgjidhja e problemeve.

STAFI AKADEMIK

Prof. Dr. **Vasilika Kume**
Prof. Dr. **Elvin Meka**
Prof. Asoc. Dr **Indrit Baholli**
PhD. **Elida Motro (Iljazi)**
PhD. **Ani Mbrica**
Dr. **Lorenc Gordani**
PhD. **Kristi Vako**
Magjistër **Albana Misja**
Dr. (c). **Afrim Osmani**
Prof. Asoc. Dr. **Rezart Dibra**
Prof. Dr. **Endri Papajorgji**
LLM. **Enik Pogaçe**
Dr. **Abaz Aliko**
Magjistër **Maela Alicanaj**
Dr. **Elona Garo**
MSc. **Miranda Misini**

4

GRUPET E DISKUTIMIT DHE PROJEKTET:

Bashkëpunimi përmes diskutimeve dhe projekteve në grupe ndihmon në zhvillimin e aftësive për komunikim, menaxhim dhe bashkëpunim.

5

PROJEKTE DHE PUNË PRAKTIKE:

Përfshirja e studentëve në projekte ose praktikë në institucione dhe kompani reale i ndihmon ata të lidhin teorinë me zbatimin në terren.

6

E-LEARNING DHE REFLEKTIMI:

Përdorimi i teknologjisë dhe procesi i reflektimit mbi përvojat e tyre siguron përmirësim të vazhdueshëm të aftësive personale dhe profesionale.

INFORMACION PRAKTIK



PROGRAM LËNDOR NË TË DREJTË BIZNESI

Program i masterit 2-vjeçar në të Drejtë Biznesi
përfshin njohuri themelore, të avancuara dhe praktike:

VITI I PARË

Semestri 1: Hapat e parë në të Drejtë dhe Biznes

Nr.	Lënda	Lektorët	Kredite
1	Zhvillim Personal dhe Komunikim Ndërpersonal	Elida Motro (Iljazi) <i>PhD</i>	6
2	Sjellje Organizative dhe Lidership	Elida Motro (Iljazi) <i>PhD</i> Ani Mbrica <i>PhD</i>	6
3	E Drejta e Punës	Lorenc Gordani <i>PhD</i> Kristi Vako <i>PhD</i>	6
4	E Drejta Civile dhe Kontratat	Lorenc Gordani <i>PhD</i> Albana Misja <i>Magjistër</i>	6
5	Mjedisi Rregullator i Biznesit	Lorenc Gordani <i>PhD</i> Afrim Osmani <i>Dr.(c)</i>	6

Semestri 2: Avancimi në Kuadrin Ligjor dhe Qeverisjen e Biznesit

Nr.	Lënda	Lektorët	Kredite
1	Qeverisja e Korporatave	Rezart Dibra <i>Prof. Asoc. Dr.</i>	6
2	E Drejtë Biznesi e Avancuar	Lorenc Gordani <i>PhD</i> Endri Papajorgji <i>Prof. Dr.</i>	6

3	Menaxhim Strategjik	Vasilika Kume <i>Prof. Dr.</i>	6
4	E Drejta Bankare dhe Financiare	Elvin Meka <i>Prof. Dr.</i> Enik Pogaçe <i>LLM</i>	6
5	Taksim Biznesi	Abaz Aliko <i>Dr.</i> Maela Alicanaj <i>Magjister</i>	6

VITI I DYTË

Semestri 3: Menaxhimi i Projekteve dhe Drejtimi Financiar

Nr.	Lënda	Lektorët	Kredite
1	Drejtim Financiar i Avancuar	Abaz Aliko <i>Dr.</i>	6
2	Menaxhim Projektsh	Elona Garo <i>Dr.</i>	6
3	Vlerësimi Projekteve	Ani Mbrica <i>PhD</i> Miranda Misini <i>MSc</i>	6
4	E Drejta Fiskale dhe e Krahasuar	Abaz Aliko <i>Dr.</i> Maela Alicanaj <i>Magjister</i>	6
5	Menaxhimi i Sistemeve të Informacionit të Avancuar	Indrit Baholli <i>Prof. Asoc. Dr.</i>	6

Semestri 4: Praktika dhe Finalizimi i Studimeve

Nr.	Lënda	Lektorët	Kredite
1	Praktikë Profesionale dhe Raporti i Përvojës Profesionale	Komision	12
2	Temë Diplome/ Provimi i Përgjithshëm Përfundimtar	Komision	18

MASTER NË ADMINISTRIM BIZNESI ME PROFIL NË TË DREJTË BIZNESI

Kohëzgjatja:

2 vite akademike (4 semestra)

Forma e studimit:

Me kohë të plotë

Gjuha:

Shqip

📍 Rruga Rezervat e Shtetit,
Lundër, Tiranë, Shqipëri

☎ +355 69 70 66 966

✉ admissions@tbu.edu.al

🌐 www.tbu.edu.al

DIPLOMA MASTER PROFESIONAL
NË ADMINISTRIM BIZNESI
ME PROFIL E DREJTË BIZNESI
ME 120 ECTS

KRITERET E PRANIMIT:

- Diplomë e nivelit Bachelor;
- CV;
- Letër Motivimi;
- Dokument Identifikimi.

Master në Administrim Biznesi
Me profil në të Drejtë Biznesi

KONTAKT:

DR. LORENC GORDANI
Drejtor Akademik

✉ lorenc.gordani@tbu.edu.al

☎ +355 68 307 64 88